



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:164347
Datë: 29.09.2023
Numri i dokumentit: 04738795

PKR.nr.78/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit D.F.nga P., për veprat penale, “Vrasje e mbetur në tentativë” nga neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda PP/L.nr.69/2023 të datës 31.08.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 20.09.2023, në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, mbrojtësit të viktimave Luan Mehmetaj, të akuzuarit D.F.dhe mbrojtësit të tij me autorizim av.Mustafë Kastrati nga Peja, si dhe palës së dëmtuar E. H. nga P., me datë 20.09.2023 mori dhe shpalli, si dhe me datë 29.09.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. F., i lindur me datë, në P., ku edhe banon, rr. “M. Z.”, nr..., i biri i I. dhe i nënës H. e gjinisë S., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion mjeshtrë ndërtimtar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Më datë 28.07.2023 në ora 06:09:33, në rr. “A. J.”, K. P., pikërisht në hyrje të tunelit të Rrokaqiellit, me dashje ka tentuar të privoi nga jeta të dëmtuarin E.H. nga P. në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje të mëparshme në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit, rreth akuzave se kinse i dëmtuari ia ka ngacmuar të dashurën të pandehurit, e për të cilën mosmarrëveshje ishin pajtuar, i pandehuri D. natën kritike me të dal nga diskoteka e cila gjendet në f. P., e thërret në telefon të dëmtuarin E. i cili ka qenë në shoqëri me dëshmitarët A. dhe D., dhe të njëjtit i ka thënë “më ke pre në besë”, e më pas edhe fjalosën, ashtu që gjersa i dëmtuari E. ka shkuar për tu takuar me personin i cili ka ndërmjetësuar për pajtim dëshmitarët A. dhe D. nga P. C. janë nisur për në P., e të përcjellur nga i pandehuri D., i cili në momentin kur dëshmitari A. dhe D. arrijnë tek rrokaqielli në P., me qëllim për të shkuar në banesë, pas veturës së tyre, arrin i pandehuri i cili ndalet në mes tunelit me veturën e tij G. .. ngjyrë të zezë me targa ..-...-..., dhe në momentin kur dëshmitari A. del nga vetura, e vëren të pandehurin të cilit i drejtohet me fjalët “çka u bo bre D., a je tiu na ndjek neve”, i njëjti kthehet me fjalë “unë nuk kam punë me ty po ku është E.”, e në këtë moment arrin i dëmtuari E. me veturën e tij G.. . ngjyrë metalike me

targa ...-... dhe i njëjti ndalet në trotuar afër tunelit në mënyrë horizontale, me qëllim me u parku në parking, i njëjti vërehet nga i pandehuri i cili i drejtohet me revole në dorë duke-shkrepur në drejtim të dëmtuarit 8 herë, ku i dëmtuari largohet me shpejtësi nga vendi i ngjarjes, kurse i pandehuri i vihet nga pas duke e ndjekur fillimisht në këmbë e më pas me veturë.

-Me çka ka kryer veprën penale, “Vrasje e mbetur në tentativë” nga neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së.

II. Më parë e gjerë me datën 28.07.2023, në rr. “A. J.”, K. P., në kundërshtim me Ligjin mbi armët, i pandehuri ka poseduar armën e llojit Pistoletë, prodhim Ç. S., V. ..., me numër serik C bashkë me një karikator të zbrazët, në atë mënyrë me të njëjtën armë ditën kritike i pandehuri D. F., ka kryer veprën penale të cekur si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze.

-Me çka ka kryer veprën penale “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21 par. 2, 38, 39, 40, 42,43, 69,70,71,72 të KPRK-së, neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së, neni 366 par.1 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

Për veprën penale si në dispozitivin e I, i caktohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 28.07.2023 e gjerë me datë 20.09.2023.

Për veprën penale si në dispozitivin e II, i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 1000€ (njëmijë euro).

Dënimi me burg dhe dënimi me gjobë të cekura si më lartë do të ekzekutohen më së largu në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftë se i akuzuari dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat të caktuar atëherë i njëjti dënim do të shndërrohet me dënim me burg duke ju llogaritur një ditë burg për çdo 20€ (njëzet euro) të gjobës.

Të akuzuarit i konfiskohet arma prodhim Ç. ... me numër serik bashkë me një karikator të zbrazët.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), në emër të shpenzimeve gjyqësore shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) si dhe në emër të kompozimit të viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit me dt.20.09.2023 i është ndërprerë masa e paraburgimit.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.69/2023 të datës 31.08.2023, ndaj të akuzuarit D.F.nga P., rr. “M. Z.”, nr..., për vepër penale, “Vrasje e mbetur në tentativë” nga neni 172 e lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe për vepër penale “Mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar mbajtën e shqyrtimit fillestar me datë 20.09.2023, pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/I.nr.69/2023 të datës 31.08.2023, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tij, pastaj akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i akuzuari D.F.pas konsultimit me mbrojtësin e tij ka deklaruar se i ka të qarta pasojat dhe përpirësit e pranimin të fajësisë, e pranon fajësinë për dy veprat penale që i vihen në barrë, pranimin e fajësisë e bënë vullnetarisht pa kurrfarë presioni apo ndikimi nga askush, i vjen keq për atë që ka ndodhur.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, meqenëse pranimi është i bazuar dhe i provuar edhe në provat të cilat janë bashkangjitur aktakuzës, ashtu që i propozon Gjykatës që ta aprovoi.

Mbrojtësi i viktimave Luan Mehmetaj ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë.

Pala e dëmtuar E.H. ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Mustafë Kastrati ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë dhe është bërë në konsultim me të dhe si mbrojtës është bindur se pranimi i fajësisë është në favor të tij.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 248 të KPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 241 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata e ka shpallë fajtor të akuzuarin marrë parasysh pranimin e fajësisë dhe prova të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohëshëm të sendeve-telefonit të të dëmtuarit me nr.....-...-...../.....-...-..., raporti i oficerit A. G. dt. 28.07.2023, nr.....-...-....., raporti i oficerit A. Sh. dt. 28.07.2023 nr.-...-....., raporti i oficerit F. D. dt. 28.07.2023 nr.....-...-....., raporti fillestar i incidentit dt.28.07.2023, nr.-...-....., raporti i policit hetues N. G. nr.-...-... dt. 08.08.2023, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, Lista e dëshmimeve, zingjiri i ruajtjes, skicimi, fotoalbumi i vendit të ngjarjes, 1 CD e vendit të ngjarjes e marrë nga Qendra Operative në P., raporti i ekzaminimit të telefonit nr. A.-...-..... i datës 09.08.2023 si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Palët në procedurë kanë deklaruar se janë të gatshëm të deklarohen lidhur me rrethanat për dënimin dhe nuk është e nevojshme caktimi i ndonjë seance.

Lidhur me rrethant për dënimin prokurorja ka deklaruar: me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit si rrethana rënduese i propozon Gjykatës që përveç asaj që ka deklaruar i njëjti më parë ka qenë i dënuar ta vlerësoi shkallën e lartë të dashjes nga i akuzuari për të kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, kurse si rrethana lehtësuese i propozon Gjykatës që të vlerësoi fillimisht pranimin e fajësisë më pas keqardhjen e shfaqur nga i akuzuari për veprën e të cilën keqardhje e ka shpreh që nga momenti i kryerjes së veprës penale edhe sot duke premtuar se ky do të jetë rasti i fundit, po ashtu si rrethana lehtësuese të vlerësohet pajtimi i arritur në mes të akuzuarit dhe palës së dëmtuar i cili pajtim u arrit sot me ndërmjetësimin e prindit të akuzuarit.

Lidhur me rrethanat për dënimin mbrojtësi i viktimave Luan Mehmetaj ka deklaruar se pajtohet me ato çka tha prokurorja duke shtuar se të viktima natyrisht kjo ka ndikuar negativisht dhe shumë keq për shkak se kanë qenë shok të ngushtë dhe e njëjta i kishte rënë në befasi, mirëpo siç e pamë të gjithë këtu në seancë viktimia shprehi dëshirën që të pajtohet me të akuzuarin dhe njëkohësisht kërkoi që të mos të përsëritet ndonjë veprim në mes tyre.

Lidhur me rrethanat për dënimin pala e dëmtuar E.H. ka deklaruar: se nuk ka diçka për të thënë, nuk kërkon dëmshpërblim, nuk ka dëshirë të ndjeket penalisht, përkatësisht nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Lidhur me rrethanat për dënimin Mbrojtësi i të akuzuarit D. F., av. Mustafë Kastrati ka deklaruar, deklaron fillimisht shpreh mirënjohjen dhe konsideratën ndaj këtu të dëmtuarit për qëndrimin dhe aktin e tij për pajtim me të akuzuarin. Gjykata gjatë marrjes së vendimit për dënim të merr parasysh këtë akt të pajtimit të palëve, pendimin e sinqertë, kërkim faljen e sinqertë që nga dita e nesërme e ndodhjes së rastit dhe në vazhdimësi nga këtu i akuzuari të merr parasysh faktin se konflikti ka qenë i pa planifikuar dhe pa paramendim dhe faktin se këtu i akuzuari ka premtuar në mënyrë të sinqertë asnjëherë më nuk do të përsëritet. Meqenëse nuk ekzistojnë me asnjë arsye për mbajtjen e të akuzuarit në paraburgim Gjykatës i parashtrajnë kërkesë që ndaj të akuzuarit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit ti ndërpritet paraburgimi dhe ti zëvendësohet me ndonjë masë alternative, meqenëse kanë pushuar të gjitha kushtet për vazhdimin e paraburgimit, me këtë rast e falënderon edhe prokuroren dhe efikasitetin, D. dhe E.

I akuzuari D.F.ka deklaruar se i vjen keq për këtë, i kërkon falje drejtpërdrejtë para Gjykatës, nuk do të përsëritet.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratimet e palëve të cekura më lartë dhe duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Nga rrethanat lehtësuese gjeti se e ka pranuar fajësinë në seancë fillestare, pendimin e thellë dhe kërkim faljen si dhe pajtimin me palën e dëmtuar. Nga rrethanat rënduese gjeti se më parë ka qenë i dënuar me aktgjykimet P.nr. 147/13 dt.25.04.2013 dhe P.nr.978/13 dt.05.08.2019, pastaj shkallën e lartë të dashjes që vërtetohet me mënyrën e kryerjes së veprës penale ku i njëjti shtënë 8 herë në drejtim të dëmtuarit dhe kur i dëmtuari arrin të largohet i njëjti i vihet pas duke e ndjekur.

Gjykata me rastin e përcaktimit të dënimit për secilën vepër penale ka vlerësuar fatin se për veprën penale nga neni 172 parashihet minimumi i dënimit 5 vite. Mirëpo marrë parasysh rrethanat e cekura si më lartë veçanërisht rrethanat lehtësuese siç janë pranimin e fajësisë dhe pendimin, e që me dispozitën e nenit 71 dhe 72 par. 1 nën par. 1.2 të KPPRK-së ku parashihet: nëse për veprën penale minimumi i dënimit është pesë vite dënimi mund të zbutet deri në tre vite burgim. Pastaj faktin se si pasoj e veprës ka vetëm dëme materiale, nuk ka lëndime, i

dëmtuari nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon dëmshpërblim, vepra ka mbetur në tentativë, gjykata ka përcaktuar dënimin nën minimumin e paraparë ligjor duke u bazuar në dispozitën e nenit 28 i cili ndër të tjera parasheh që *dënimi mund të zbutet*.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të cekura më lartë të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se dënimet e cekura si më lartë janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, siç është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

I dëmtuari gjatë seancës fillestare ka deklaruar se nuk ka kërkesë për dëmshpërblim andaj nuk u udhëzuar në kontest civil.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së gjykata e mori vendimin mbi konfiskimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Konform nenit 450 të KPPRK-së, gjykat e obligoi të akuzuarin në paguarjen e paushallit gjyqësor dhe shpenzimeve të procedurës penale.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin që të paguaj shumën e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit me aktvendimin PKR.nr.78/2023 të datës 20.09.2023 i është ndërprerë masa e paraburgimit, arsyet për ndërprerje janë dhënë në aktvendim.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,
2023:164347, 29.09.2023**

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.